



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:083372  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05732045

**K.Dh.Sh II.nr.95/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Wineplant” SH.P.K, me NUI 811392068, me seli në rr. “Azem Bejta” Nr. 40, në Prizren, kundër debitorit I.B. B.I., me NUI: 811374371, me seli në Fshatin Arllat - rr. “Abedin Bujupi” Nr. 4, në Gllogoc, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2477/22 të datës 30.06.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit I.B. B.I., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2477/22 të datës 30.06.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2477/22 të datës 30.06.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit I.B. B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.524/22 të datës 19.10.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2477/22 të datës 30.06.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqit kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Wineplant” SH.P.K, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 09/2022, me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur, t’i paguaj kreditorit shumën prej 6,900.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, me realizimin e përmbarimit përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare, sekuestrimin, vlerësimin, shënimin e përmbarimit të librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në pagesën definitive.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjera se fatura e lëshuar nga kreditori, është e nënshkruar nga personi i paautorizuar, përkatësisht ish bashkëshortit e cila vërtetohet nga nënshkrimi i dhënë nga ana e tij. Më tutje ka theksuar se vula të cilën e ka përdorur ish bashkëshorti, debitori nuk e ka në posedim, për shkak të ndarjes dhe për këtë është shqiptuar masa mbrojtëse. Debitori ka deklaruar se në rastin konkret kemi të bëjmë me një faturë fiktive dhe të falsifikuar dhe të nënshkruar nga ish bashkëshorti, i cili ka qenë i autorizuar sipas autorizimit përkatës, por që ky autorizim është revokuar. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri Përmbarimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim duke theksuar se qëllimi i debitorit është shtyrja dhe prolongimi i pagesës së borxhit që ka ndaj kreditorit. Ka deklaruar se fatura është në origjinal dhe e njëjta gjatë nënshkrimit është prezantuar autorizimi i datës 16.06.2020, ndërsa revokimi i autorizimit nga debitori është bërë me datë 13.09.2022 dhe se kreditori nuk ka qenë në dijeni se tek pala debitore kanë pasur probleme bashkëshortore. Më tutje ka theksuar se debitori me Ministrinë e Bujqësisë kanë nënshkruar kontratë për subvencionim për furnizim me vreshta të rrushit nga ana e kreditorit e cila i ka lëshuar faturën dhe debitori ka qenë në dijeni, për më tepër e njëjta ka hapur biznes individual për fitimin e këtij granti. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar, urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi, si dhe të obligohet debitori që të paguaj borxhin kryesor si dhe të gjitha shpenzimet e tjera të procedurës dhe në rast të ankesës të paguaj garancionit bankar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2477/22 të datës 30.06.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit I.B. B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.524/22 të datës 19.10.2022, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar*”, e që në rastin konkret fatura është e pranuar dhe e nënshkruar nga ana e debitorit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të debitorit se fatura nuk ka tipare të përmbartueshmërisë pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit, andaj e njëjta është e manipuluar dhe falsifikuar, por që pretendimin në fjalë e vlerësoj si të bazuar për faktin se debitori nuk ka ofruar prova që debitori ka iniciuar ndonjë procedurë të veçantë për të kontestuar validitetin e nënshkrimit të dhënë në emër të saj si në faturë, ndërsa për Gjykatën, mungesa e emrit të personit i cili e nënshkruan faturën, nuk e zhvesh nga tiparet e përmbartueshmërisë faturën e nënshkruar. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera të debitorit mirpo nuk kishin ndikim ndryshe në këtë çështje përmbartimore ngase nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj edhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formal të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi.

Andaj, nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se

përmbarrimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.Dh.Sh II.nr. 95/24 , datë:24.05.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2024:083372  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05732045